



**STUDIMET DOKTORALE NË FAKULTETIN E EDUKIMIT
DHE NË FAKULTETIN FILOZOFIK
TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS**

Punim për diskutim

Mars 2018

Ky botim është pjesë e projektit “Orteku në Arsimin e Lartë: Studimet e Doktoratës në Shkencat Sociale dhe Humanistike në Universitetin e Prishtinës” dhe është realizuar me përkrahjen e projektit *Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP)* të financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K), dhe të Bashkëpunimit për Zhvillim Ndërkombëtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Danimarkës (DANIDA), dhe i menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) dhe Qendrës për Kurajo Politike (CPC), dhe kursesi nuk mund të konsiderohet qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-s apo i KCSF-së.

Përgatitur nga: Mentor Agani

Editorë: Lulzim Peci dhe Arben Hajrullahu

Asistente hulumtuese: Lirije Palushi

Copyright © 2018, KIPRED & CPC. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në çfarëdo sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: info@kipred.org dhe: info@cpc-ks.org .

Përmbajtja

1. Hyrje	4
2. Aspektet legale të administrimit të studimeve doktorale në UP	7
2.1 Regjistrimi në studimet e doktoraturës	8
2.2 Kohëzgjatja dhe fazat e studimeve të doktoratës	9
2.3 Procedurat e paraqitjes, vlerësimit dhe pranimit të projektit të doktoratës, dhe të vlerësimit e mbrojtjes së punimit të doktoratës	10
2.4 Emërimi, riemërimi dhe avancimi i personelit akademik në UP	11
3. Akreditimi	12
3.1 Akreditimi i Programit Doktoral në Fakultetin e Edukimit	12
3.2 Akreditimi i Programeve Doktorale në Fakultetin Filozofik	14
3.2.1 Akreditimi i Programit Doktoral në Departamentin e Historisë	15
3.2.2 Akreditimi i Programit Doktoral në Departamentin e Sociologjisë	16
3.3 Aspekte akredituese të studimeve doktorale në UP	18
3.3.1 Vlerësimi i përgjithshëm i procesit akreditues të programeve doktorale	19
3.3.2 Akreditimi i profesorëve për mësimdhënie dhe mentorim në studimet doktorale	20
4. Aspekte të administrimit, cilësisë dhe resurseve hulumtuese në studimet e doktoratës	24
4.1 Administrimi i studimeve doktorale dhe çështja e resurseve për këto studime .	24
4.2 Kriteret e pranimit në studimet doktorale	27
4.3 Cilësia e studimeve doktorale	29
4.4 Hulmtimi dhe aspektet e studimeve doktorale të ndërlidhura me të	32
5. Konkluzione për diskutim	38

1. HYRJE

Hulumtimi *Orteku në Arsimin e Lartë: Studimet e Doktoratës në Shkencat Sociale dhe Humanistike në Universitetin e Prishtinës* është duke u realizuar bashkarisht nga Instituti Kosovar për Zhvillim dhe Hulumtim të Politikave – KIPRED dhe Qendra për Kurajo Politike – CPC, dhe përkrahet nga projekti Përhapja e Shoqërisë Demokratike i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe DANIDA, Bashkëpunimi për Zhvillim Ndërkombëtar, i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Danimarkës, menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përndryshe, ky projekt ka për qëllim hulumtimin e studimeve doktorale në katër fakultete të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ku studiohen shkencat sociale dhe humanistike: në Fakultetin Ekonomik, Fakultetin Juridik, Fakultetin e Edukimit dhe Fakultetin Filozofik.

Siç është përmendur edhe në Punimin Diskutues të Parë, *Studimet Doktorale në Fakultetin Ekonomik dhe atë Juridik të Universitetit të Prishtinës* (nëntor 2017), hulumtimi është duke u zhvilluar në tre faza. Në fazën e parë analizohen studimet doktorale në Fakultetin Ekonomik dhe në atë Juridik. Tash, në fazën e dytë, analizohen studimet doktorale në Fakultetin e Edukimit dhe në atë Filozofik. Përndryshe, ky Punim Diskutues është njëri nga produktet finale të fazës së dytë ku ofrohen gjetjet paraprake. Njësoj si edhe në fazën e parë, dy produktet tjera të kësaj faze të dytë janë Tryeza Diskutuese, ku këto gjetje dhe analiza paraprake do të prezantohen para palëve me relevancë për temën, si dhe prezantimi dhe përhapja e tyre në opinionin publik. Ndërkaq, në fazën e tretë do të realizohet përmbledhja e gjetjeve dhe analizave paraprake, si dhe e përfundimeve të dy tryezave diskutuese duke mundësuar ofrimin e rezultateve të hulumtimit si dhe rekomandimet përkatëse për avancimin dhe ngritjen e cilësisë së studimeve doktorale në Universitetin e Prishtinës. Në këtë mënyrë, në fazën e tretë do të ofrohet një analizë përmbledhëse e të gjitha gjetjeve paraprake nga dy fazat e para që do ta ketë trajtën e një punimi të politikave me rekomandimet përkatëse.

Përndryshe, ky Punim Diskutues përbëhet nga gjithsej pesë pjesë, ku kjo Hyrje është e para prej tyre. Në pjesën e dytë ofrohet një përshkrim i shkurtër dhe një analizë paraprake e

dokumenteve legale-normative që e rregullojnë zhvillimin e studimeve të doktoratës në Universitetin e Prishtinës. Meqë aspektet legale-normative janë të vlefshme njëjtë për të gjitha fakultetet dhe programet doktorale, atëherë kjo pjesë ngel e njëjtë si në Punimin Diskutues të Parë. I vetmi dallim është që këtu është përfshirë edhe *Rregullorja për Procedurat Përzgjedhëse Lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina,"* miratuar më 2 mars 2018 nga Senati i UP-së. Në pjesën e tretë analizohet procesi i akreditimit të programeve doktorale të Fakultetit të Edukimit dhe të Fakultetit Filozofik. Fillimisht analizohen hollësitë rreth akreditimit për çdonjërin fakultet dhe për programet veçmas. Këtu theksohen anët e forta dhe të dobëta të çdonjërit program veçmas, ashtu siç ato janë dhënë nga grupet e ekspertëve ndërkombëtarë që e kanë bërë vlerësimin e tyre për akreditim. Përqëndrimi është para së gjithash në rekomandimet që i kanë dhënë këto grupe ekspertësh. Më pas shqyrtohen disa aspekte akredituese të studimeve doktorale në UP, ku përqëndrimi është në një vlerësim të përgjithshëm të procesit akreditues të programeve doktorale, si dhe në përshkrimet dhe analizën e pikëpamjeve që respondentët i kanë dhënë lidhur me idenë për akreditimin e profesorëve për mësimdhënie dhe mentorim në studimet doktorale. Në pjesën e katërt trajtohen disa aspekte të rëndësishme të administrimit, cilësisë dhe resurseve hulumtuese për studimet e doktoratës. Kjo pjesë në masën më të madhe mbështetet në përgjigjet e ofruara nga respondentët gjatë realizimit të intervistave. Këtu theksi bie në administrimin e studimeve doktorale dhe në çështjen e resurseve për këto studime, për të vazhduar më pas me kriteret e pranimit në studimet doktorale, si dhe me aspektet e cilësisë së tyre. Pas kësaj shqyrtohen edhe aspektet e studimeve doktorale të ndërlidhura me hulumtimin, duke u përqëndruar në çështjet e publikimeve ndërkombëtare, ato të bibliotekave, të literaturës, të instituteve, dhe të botimit të revistave shkencore. Pjesa e pestë i jep konkluzionet paraprake dhe temat për diskutim.

Në fund po i përmendim pjesëmarrësit në intervistat e zhvilluara. Nga Fakulteti i Edukimit këta janë: Profesor Dr. Blerim Saqipi, Profesor Dr. Demë Hoti, Profesoreshë Dr. Eda Vula, Profesoreshë Dr. Majlinda Gjelaç, si dhe studentët doktoralë Mr. Ismet Potera, Mr. Rajmonda Kurshumlia dhe Mr. Shqipe Gashi. Ndërkaq, nga Fakulteti Filozofik këta janë: Profesor Dr. Agim

Hyseni, Profesor Dr. Arben Hajdari, Profesor Dr. Bujar Dugolli, Dekan i Fakultetit, Profesor Dr. Muhamet Mala, Asistentja Dr. Linda Gusia, Asistente, si dhe studenti doktoral Mr. Albert Mecini (Sociologji) së bashku me dy studentë/e të tjerë/a doktoralë që janë pajtuar që mendimet e tyre të shfrytëzohen për këtë hulumtim, por duke ngelur anonim. Në punim këtyre dy studentëve doktoral, e që janë nga drejtime të ndryshme, do t'i referohemi si Doktoranti/ja 1 dhe Doktoranti/ja 2.

KIPRED-i dhe CPC-ja ju shprehin falënderime të gjithëve për kontributin e dhënë për këtë hulumtim.

2 ASPEKTET LEGALE TË ADMINISTRIMIT TË STUDIMEVE DOKTORALE NË UP¹

Studimet doktorale në UP rregullohen dhe administrohen në bazë të ligjeve dhe dokumenteve legale vijuese: Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Statuti i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe Rregullorja për Studimet e Doktoratës e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.²

Organet kryesore për marrjen e vendimeve relevante për zhvillimin e studimeve të doktoratës në UP janë Këshilli Qendror i Studimeve të Doktoratës, si Këshill i përhershëm i Senatit të UP-së, Këshilli i Studimeve të Doktoratës i Njësisë Akadematike – Fakultetit, si Këshill i përhershëm i Këshillit të Fakultetit, pastaj Këshilli i Fakultetit, si dhe Senati i UP-së, si një organ për miratimin përfundimtar të vendimeve të propozuara nga organet e sipërpërmendura.

Këshilli Qendror i Studimeve të Doktoratës përbëhet nga 14 anëtarë: Rektori, Prorektori për kërkime shkencore, Prorektori për mësim, një përfaqësues i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, dhe dhjetë profesorë të rregullt ose të asocuar nga këta lëmenj: lëmi i shkencave shoqërore, lëmi i shkencave humanistike, lëmi i shkencave teknike, lëmi i arteve, lëmi i shkencave matematike-natyrore, lëmi i mjekësisë, lëmi i shkencave të bujqësisë dhe veterinarisë, lëmi i shkencave juridike, lëmi i shkencave ekonomike dhe lëmi i edukimit fizik dhe sportit. Po ashtu, anëtar i këtij Këshilli është edhe Drejtori i Zyrës për Zhvillim Akademik, por ky është anëtar pa të drejtë vote.³

¹ Siç u tha në Hyrje, ky kapitull është marrë në tërësi dhe është identik me kapitullin përkatës në Punimin Diskutues të Parë të nëntorit 2017. Dy ndryshimet e vetme janë shtimi i kësaj fusnote, dhe shtimi i seksionit të fundit në kapitullin e këtushëm, 2.4 Emërimi, riemërimi dhe avancimi i personelit akademik në UP, që është bërë si pasojë e miratimit në ndërkohë (02.03.2018) të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UP.

² Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, 04/L-037, 29 gusht 2011, <http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20arsimin%20e%20larte.pdf>. ; Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, 04/L-135, 28 mars 2013, <http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20veprimtari%20kerkimore%20shkencore.pdf>. Statuti i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”; dhe Rregullore për Studimet e Doktoratës e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” 2.9.2016. Dy dokumentet e fundit janë në dispozicion në: <http://www.uni-pr.edu/>.

³ Rregullore për Studimet e Doktoratës, Neni 2.2.

Studimet e doktoratës i udhëheq Këshilli i Studimeve të Doktoratës në njësinë përkatëse akademike – fakultet,⁴ dhe ky përbëhet nga 5 ose 7 anëtarë nga radhët e profesorëve nga çdonjëri departament i njësisë akademike.⁵

Po ashtu, çdo njësi akademike – fakultet, ka Këshillin e Fakultetit, anëtarët e të cilit janë dekani i fakultetit, prodekani/prodekanët, sekretari i fakultetit, deri në tridhjetë anëtarë të zgjedhur nga radhët e profesorëve të fakultetit, deri në 8 anëtarë të zgjedhur nga radhët e asistentëve të fakultetit, një anëtar i zgjedhur nga personeli joakademik i fakultetit, dhe dy përfaqësues të studentëve, të zgjedhur nga këshilli i studentëve të fakultetit.⁶

Dhe, në fund, Senati i Universitetit është organi më i lartë akademik i Universitetit,⁷ që ka këtë përbërje: rektori, prorektorët, dekanët e të gjitha njësive akademike – fakulteteve, nga një anëtar nga stafi akademik i çdonjërës njësi akademike, shtatë anëtarë nga parlamenti i studentëve, dhe dy anëtarë nga stafi joakademik. Sekretari i Universitetit është anëtar i përhershëm i Senatit pa të drejtë vote.

2.1 Regjistrimi në studimet e doktoraturës

Sipas Rregullores për Studimet e Doktoratës, regjistrimi në këto studime bëhet me konkurs publik që shpallet të paktën një muaj para fillimit të vitit akademik, dhe të drejtë konkurrimi kanë personat që kanë magjistraturë shkencore, titullin master shkencor, të diplomuarit që kanë të paktën 300 ECTS kredite, kandidatët me notë mesatare jo më të ulët se 8.00 në çdonjërin nivel të studimeve paraprake, dhe kandidatët që kanë dëshminë për njohjen e një gjuhe botërore (anglisht, gjermanisht, frengjisht, ose gjuhë tjetër botërore).⁸

Kriteret për regjistrim përfshijnë suksesin në studimet paraprake, interesimin për kërkime shkencore, punimet e botuara dhe rekomandimet e dy profesorëve nga lëmi përkatës. Kriteret

⁴ *Ibid.*, Neni 3 (3).

⁵ *Ibid.*, Neni 2.1.

⁶ Statuti i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Neni 73.

⁷ *Ibid.*, Neni 42.

⁸ Rregullore për Studimet e Doktoratës, Neni 7 (2). Ashtu siç është parashtruar këtu, kriteri i dëshmisë së njohjes së një gjuhe të huaj botërore, mundëson të drejtën e konkurrimit për regjistrim në studimet e doktoratës, dhe nuk është kusht për regjistrim në to.

për përcaktimin e përparësisë në radhitjen përzgjedhëse janë nota mesatare, aktiviteti kërkimor-shkencor dhe njohja e gjuhës angleze ose e ndonjë gjuhe tjetër botërore. Nota mesatare në studimet themelore dhe ato master vlerësohet me vlerë maksimale prej 40 pikësh (nota mesatare 8–8.50, 5 pikë; 8.51–9.00, 10 pikë; 9.01–9.50, 15 pikë, dhe 9.51–10.00, 20 pikë. Në kuadër të kësaj, magjistratura shkencore ose specializimi vlerësohen me 5 pikë).⁹ Aktiviteti kërkimor-shkencor vlerësohet deri në 35 pikë, ku vlerësohen artikujt e botuar në pesë vitet e fundit të indeksuar në *Current Contents*, artikujt e botuar në pesë vitet e fundit në revista të tjera ndërkombëtare të indeksuara, artikujt e botuar në pesë vitet e fundit në revista akademike vendëse (UP, ASHAK, Instituti Albanologjik dhe ai i Historisë), librat universitarë të botuar në pesë vitet e fundit, prezantimet gojore të punimit në pesë vitet e fundit në tubime shkencore ndërkombëtare të indeksuara, dhe prezantimet gojore në tubimet shkencore vendëse.¹⁰ Dhe, së fundi, njohuria e gjuhës angleze ose e një gjuhe të huaj botërore vlerësohet deri në 20 pikë.¹¹

Po ashtu, numrin e studentëve për regjistrim e propozon njësia akademike – fakulteti, e shqyrton Këshilli Qendror i Studimeve të Doktoratës, dhe e miraton Senati.¹²

2.2 Kohëzgjatja dhe fazat e studimeve të doktoratës

Kohëzgjatja e studimeve të doktoratës në UP është gjashtë semestra, dhe gjatë tyre studentët i fitojnë: 30 ECTS në semestrin e parë, për dhënien e provimeve nga lëndët e këtij semestri; 30 ECTS në semestrin e dytë, për punimet seminarike në lëndët e këtij semestri; 30 ECTS për vlerësimin pozitiv dhe miratimin e projekt-propozimit të doktoratës; 90 ECTS në tre semestrat e fundit, dhe atë, për të paktën një publikim shkencor të rezultateve të doktoratës në një revistë të indeksuar (20 ECTS), të paktën dy prezantimeve në tubimet shkencore, ku njëra duhet të jetë ndërkombëtare (10 ECTS), dhe mbrojtjes publike të doktoratës (60 ECTS).¹³

⁹ *Ibid.*, Neni 7 (4) 1. dhe 2.

¹⁰ *Ibid.*, Neni 7 (4) 3.

¹¹ *Ibid.*, Neni 7 (4) 4.

¹² *Ibid.*, Neni 7 (2). **Vërejtje:** Me gjasë për shkak të ndonjë gabimi teknik, pika (2) e Nenit 7 në këtë Rregullore përsëritet dy herë, dhe atë me përmbajtje të ndryshme. Këtu është fjala për pikën e dytë (2) të Nenit 7.

¹³ *Ibid.*, Neni 8.

2.3 Procedurat e paraqitjes, vlerësimit dhe pranimit të projektit të doktoratës, dhe të vlerësimit e mbrojtjes së punimit të doktoratës

Propozimin e mentorit dhe të temës doktoranti e bën gjatë vitit të parë, me ç'rast paraqet titullin e temës dhe mentorin e propozuar duke arsyetuar temën e propozuar dhe pritjet e kontributit shkencor të hulumtimit, si dhe vlerësimin e shpenzimeve të hulumtimit. Pas kësaj, Këshilli i fakultetit, me propozim të Këshillit për Studimet e Doktoratës, në afat prej një muaji e emëron komisionin tre- ose pesë-anëtarësh për vlerësimin e temës, dhe eventualisht miraton propozimin për mentorin. Ky Komision, në afat prej një muaji e jep vlerësimin për kontributin shkencor të temës së propozuar. Propozimin e këtij Komisioni, Këshilli i studimeve të doktoratës të fakultetit duhet ta shqyrtojë në semestrin e tretë, dhe 30 ditë pas dorëzimit të raportit të Komisionit projekt-propozimi mbrohet para Këshillit të studimeve të doktoratës të fakultetit. Në fund, Këshilli i Fakultetit, me propozim të Këshillit të Studimeve të Doktoratës, temën dhe mentorin ia propozon Senatit të Universitetit për miratim.¹⁴

Ndërkaq, punimin e doktoratës, në formë të shkruar në letër dhe në atë elektronike, kandidati e dorëzon zyrtarisht në fakultet ose në Universitet. Me propozim të Këshillit të Studimeve të Doktoratës, Këshilli i Fakultetit e emëron Komisionin tre- ose pesë-anëtarësh për vlerësimin e punimit të doktoratës. Njëherësh me emërimin e këtij Komisioni, Universiteti e shpall në ueb-faqen e vet titullin dhe rezymenë e punimit në shqip dhe anglisht. Komisioni vlerësues është i obliguar që brenda një muaji ta përpilojë raportin e shkruar për vlerësimin e punimit të doktoratës, dhe ky vlerësim mund të jetë pranim i punimit të doktoratës, kërkesë për plotësimin e tij, dhe refuzim i tij, që e përmban arsyetimin e vendimit. Në fund, në seancën e ardhshme, Këshilli i Fakultetit, me propozimin e Komisionit, i propozon Senatit emërimin e Komisionit për mbrojtjen publike të punimit të doktoratës.¹⁵

Mbrojtja e punimit të doktoratës mund të bëhet pasi Këshilli i Fakultetit ta ketë miratuar vlerësimin pozitiv të Komisionit vlerësues, i cili duhet të ratifikohet nga Senati brenda afatit prej dy muajsh nga data e dorëzimit në Komisionin Qendror të Studimeve të Doktoratës. Nga dita e ratifikimit në Senat, doktoranti në marrëveshje me dekanin dhe me Komisionin për mbrojtje të

¹⁴ *Ibid.*, Neni 15.

¹⁵ *Ibid.*, Neni 16.

doktoratës, duhet në afat prej një muaji nga data e ratifikimit në Senat ta bëjë mbrojtjen publike të punimit të doktoratës.¹⁶ Pas mbrojtjes së punimit të doktoratës, ky botohet në faqen e Internetit të Universitetit, më së largu një muaj pas mbrojtjes.¹⁷ Doktoranti e fiton të drejtën e doktorit që nga dita e mbrojtjes së suksesshme të punimit të doktoratës, ndërkaq, të drejtat e plota të gradës akademike me rastin e promovimit.¹⁸

2.4 Emërimi, riemërimi dhe avancimi i personelit akademik në UP

Gjatë periudhës kohore nga mbajtja e Tryezës së Parë Diskutuese e deri në botimin e këtij Punimi Diskutues, Senati i UP-së e ka miratuar Rregulloren për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UP,¹⁹ e cila, mes tjerash, i përcakton kriteret lidhur me njohjen e botimeve në revistat shkencore ndërkombëtare e që mund të përdoren për përzgjedhjen e stafit akademik. Kështu, njëri ndër kriteret për përzgjedhjen në titullin e Profesorit të Rregullt është që ai/ajo t'i ketë të paktën 5 publikime në revistat ndërkombëtare,²⁰ për titullin e Profesorit të Asocuar është që ai/ajo t'i ketë të paktën 3 publikime në revistat ndërkombëtare,²¹ dhe për titullin e Profesorit Asistent është që ai/ajo ta ketë të paktën 1 publikim në revistat ndërkombëtare.²²

¹⁶ *Ibid.*, Neni 17.

¹⁷ *Ibid.*, Neni 19.

¹⁸ *Ibid.*, Neni 20.

¹⁹ "Rregullore për Procedurat Përzgjedhëse Lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"" miratuar më 2 mars 2018 nga Senati i Universitetit të Prishtinës.

²⁰ *Ibid.*, Neni 4, Paragrafi 1.2.1.

²¹ *Ibid.*, Neni 5, Paragrafi 1.2.

²² *Ibid.*, Neni 6, Paragrafi 1.2.

3. AKREDITIMI

Në këtë kapitull do të paraqiten të dhënat më të rëndësishme lidhur me procesin e akreditimit të programeve të doktoratës në Fakultetin e Edukimit dhe në Fakultetin Filozofik. Po ashtu do të shqyrtohen edhe disa ide lidhur me akreditimin që u dhanë gjatë intervistave të zhvilluara me mësimdhënësit dhe studentët doktoralë të këtyre dy fakulteteve.

3.1 Akreditimi i Programit Doktoral në Fakultetin e Edukimit

Programi doktoral *Edukim, PhD (180 ECTS)*, i Fakultetit të Edukimit është akredituar me Vendimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (26 gusht 2015). Me këtë Vendim, Fakulteti i Edukimit është obliguar po ashtu që ta hartojë Planin e Përmirësuar në bazë të rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i Ekspertëve, i cili është dashur të dorëzohet në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) deri më 30 tetor 2015 – obligim ky që është përmbushur.²³

Përndryshe, akreditimi është bërë, ndër të tjera, duke u bazuar edhe në Raportin e Vlerësimit²⁴ që grupi i ekspertëve ndërkombëtarë e kishte përpiluar pas vizitës së realizuar më 2 korrik 2015 në Fakultetin e Edukimit. Ky Program Doktoral është përgatitur në kuadrin e programit TEMPUS të Komisionit Evropian, duke u mbështetur në programin doktoral të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Ljubljanes dhe në bashkëpunim me personelin e tij. Programi në fjalë çmohet mjaft lartë nga grupi i ekspertëve vlerësues. Aspektet që çmohen më shumë kanë të bëjnë me menaxhimin e programit dhe të studentëve, personelin, hulumtimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, financat dhe infrastrukturën, si dhe me menaxhimin e cilësisë.²⁵ Për më shumë, vlerësime të larta jipen edhe për faktin që ligjërimi ofrohet në gjuhën angleze, programi zhvillohet në bashkëpunim ndërkombëtar me fakultetet përkatëse të Universitetit të Ljubljanes

²³ Agjencioni i Kosovës për Akreditim, Vendim nga Mbledhja 36 e Agjencionit mbajtur më 26.08.2015.

²⁴ *Evaluation Report, Accreditation of Doctoral Degree (PhD) Programme in Educational Sciences*, July 2015.

²⁵ Ibid.

dhe të atij të Tiranës, kriteret e pranimit janë konform praktikave më të mira ndërkombëtare si dhe i tërë programi është i orientuar kah hulumtimi dhe publikimet ndërkombëtare.²⁶

Megjithatë, krahas këtij vlerësimi mjaft të lartë të programit doktoral, Raporti e jep edhe një mori vërejtjesh, e që kanë të bëjnë, jo aq shumë me strukturën e programit të përgatitur, sa me mundësitë për jetësimin e tij në kontekstin ekzistues në Fakultetin e Edukimit dhe në UP. Me fjalë të tjera, Raporti i Vlerësimit jep vlerësim mjaft të lartë për programin, por shpreh edhe mjaft rezerva lidhur me atë se sa ky program mund të jetësohet në rrethanat e dhëna dhe me resurset ekzistuese. Për këtë arsye, Raporti e jep edhe një mori rekomandimesh me qëllim të tejkalimit të vështirësive me të cilat Fakulteti i Edukimit mund të përballlet gjatë jetësimit të tij. Disa nga rekomandimet kryesore që i bëhen Fakultetit të Edukimit lidhur me këtë program janë:

- 1) Formulimi i temave hulumtuese duke u bazuar në kapacitetet hulumtuese në fakultet dhe informimi i aplikantëve përkatës për studimet doktorale lidhur me këto tema; 2) Shfrytëzimi i mundësive për e-mësim, dhe krijimi i mundësive të mira për video-konferenca, me qëllim të përkrahjes së bashkëpunimit midis tre universiteteve të përfshira (Prishtina, Ljubljana, Tirana); 3) Analizimi i ngarkesës së punës së mentorëve, dhe, duke u bazuar në këtë, planifikimi i vendeve për studim (meqë duket që 15 studentët e planifikuar për një vit nuk mund të mbikëqyren nga stafi i tashëm akademik); 4) Organizimi, në partneritet me Universitetin e Ljubljanës, i kurseve të detyrueshme aftësuese për mentorët, me qëllim të zhvillimit të aftësive të tyre mentoruese; 5) Organizimi i një konference hulumtuese vjetore për pjesëmarrësit e studimeve doktorale (kandidatët dhe mentorët), ku ata do të mund t'i shkëmbejnë përvojat e tyre në studimet doktorale; 6) Elaborimi i një punimi të konceptit për diskutim, ashtu që të punohet një plan hulumtues dhe të përcaktohen prioritetet hulumtuese të fakultetit, e të cilat do të jenë temat hulumtuese për grupet hulumtuese dhe për studentët doktoralë; 7) Themelimi i Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim në Edukim, që do ta promovonte strategjinë hulumtuese të Fakultetit të Edukimit, dhe që do të shndërrohej në një platformë për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe për bashkëpunimin ndërkombëtar në hulumtim; 8) Hetimi i mundësive kombëtare dhe ndërkombëtare për grante hulumtuese dhe për grante për bashkëpunimin hulumtues, dhe aplikimin për to sa herë që të jetë e mundur (për të qenë më të efektshëm në

²⁶ Ibid.

fitimin e këtyre granteve, rekomandohet që disa nga anëtarët e personelit të përqendrohen vetëm në këtë qëllim); 9) Krijimi i sistemit të granteve për studentët doktoralë, që atyre do t'u ofrojë mundësi për mobilitet afatshkurtër, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në konferencat ndërkombëtare; 10) Investimi i resurseve të mjaftueshme ekonomike, ashtu që kandidatëve, mentorëve dhe mësimdhënësve të programit t'u ofrohen resurset e domosdoshme për jetësimin e projekteve të propozuara hulumtuese (këtu nënkuptohen qasja në biblioteka, në bibliotekat virtuale, në resurset hulumtuese – softuerët statistikorë dhe softuerët për hulumtimin kualitativ – si dhe qasja në rezultatet hulumtuese të hulumtuesve të tjerë – në revistat dhe në databazat ndërkombëtare); 11) Formimi i Shërbimit për Studimet Doktorale, që përmendet edhe në rregullativën e Universitetit, dhe; 12) Përpilimi i një plani të veprimit për jetësimin e programit doktoral, e i cili do t'i përmbushte qëllimet dhe rezultatet e pritura, dhe, po ashtu, edhe mbikëqyrjen e vlerësimit të këtij plani në çdo vit akademik.²⁷

3.2 Akreditimi i programeve doktorale në Fakultetin Filozofik

Në Fakultetin Filozofik janë akredituar dhe janë duke u zhvilluar dy programe doktorale, Programi Doktoral në Departamentin e Historisë, dhe Programi Doktoral në Departamentin e Sociologjisë.

Programit doktoral *Histori, PhD (180 ECTS)*, të Fakultetit Filozofik i është zgjatur periudha e akreditimit për një vit, prej 1 tetorit 2015 deri më 30 shtator 2016, me Vendimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim.²⁸ Më pas, ky program është riakredituar për periudhën pesëvjeçare, prej 1 tetorit 2016 deri më 30 shtator 2021, me Vendimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë së Agjencisë së Kosovës për Akreditim.²⁹

²⁷ Ibid. Përndryshe, këto rekomandime jipen në faqet: 4-5, 5-6, 7, 8, dhe 9.

²⁸ Agjencioni i Kosovës për Akreditim, Vendim nga Mbledhja 33 e Agjencionit mbajtur më 07.07.2015.

²⁹ Agjencioni i Kosovës për Akreditim, Vendim nga Mbledhja 36 e Agjencionit mbajtur më 26.08.2015.

Ndërkaq, Programi doktoral *Sociologji, PhD (180 ECTS)*, i Fakultetit Filozofik është akredituar për periudhën trevjeçare, prej 1 tetorit 2014, deri më 30 shtator 2017, me Vendimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë së Agjencisë së Kosovës për Akreditim (4 korrik 2014).³⁰

3.2.1 Akreditimi i Programit Doktorat në Departamentin e Historisë

Akreditimi i programit doktoral në Histori u bë duke u mbështetur në Raportin e Vlerësimit që grupi i ekspertëve ndërkombëtarë e dorëzoi më 14 korrik 2015, pas vizitës që në Fakultetin Filozofik e zhvilloi më 25-26 qershor 2015.³¹ Në Raport përmendet që ndarja e ECTS-ve në programin doktoral është në përputhje me praktikat ndërkombëtare.³² Mirëpo, edhe pse ky Raport nuk e vë në dyshim arsyeshmërinë dhe domosdoshmërinë e këtij programi, ky po ashtu e thekson që është vështirë të gjykohej ky program, së pari meqë kishte filluar të implementohet tre vite më parë, dhe, pastaj, meqë nuk ka ende studentë të suksesshëm që e kanë përfunduar këtë studim. Edhe pse në Raport thuhet që teorikisht do të duhej të kishte të tillë, meqë programi është trevjeçar, ekspertët shtojnë që është e kuptueshme që asnjë student nuk ka qenë në gjendje ta përfundojë programin, meqë dy vitet e fundit mund të mos kenë qenë të mjaftueshme që ndonjëri nga studentët t'i përfundojë studimet. Kjo është edhe arsyeja pse grupi i ekspertëve bën rekomandimin që në akreditimet e ardhshme ekspertëve të jashtëm duhet t'u jipet mundësia për të biseduar me studentët aktualë apo të kaluar, dhe që, po ashtu, duhet t'u jipen edhe disa nga disertacionet e përfunduara.³³

Lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar, thuhet që Departamenti i Historisë nuk ka vendosur kontakte hulumtuese apo mësimore ndërkombëtare, pos ndërveprimeve të herëpashershme rastësore me kolegët dhe institucionet në Shqipëri dhe Maqedoni. Rekomandohet që bashkëpunimi të institucionalizohet, dhe që personeli më me përvojë mund t'i shfrytëzojë aftësitë e veta gjuhësore për ta intensifikuar bashkëpunimin me kolegët nga Kroacia, Sllovenia dhe Mali i Zi, ashtu që Departamenti të përgatitet më mirë për aplikimet perspektive për

³⁰ Agjencioni i Kosovës për Akreditim, Vendim nga Mbledhja 31 e Agjencionit mbajtur më 01.07.2014.

³¹ *Evaluation Report, Faculty of Philosophy, University of Prishtina, Site Visit 25-26 June 2015, 14 July 2015.* fq. 31-36. Po ashtu, kjo pjesë thirret edhe në *ibid.*, fq. 21-3, 24-5, 26-7, 28-9.

³² *Ibid.*, fq. 32.

³³ *Ibid.*, fq. 31.

projektet evropiane që rregullisht kërkojnë bashkëpunim të vendeve të ndryshme, dhe të shumtën anëtarësinë në BE të ndonjërit nga vendet institucionet e të cilit janë të përfshira.³⁴

Një nga çështjet që shtrohen në këtë Raport është ajo e aftësive gjuhësore të personelit dhe të studentëve, që duhet të përkrahen me një strategji të paramenduar, si pjesë e strategjisë së tërësishme të Departamentit dhe Fakultetit. Kjo do ta ndihmonte qasjen në literaturën dhe burimet hulumtuese në gjuhët e huaja, si dhe në konferencat dhe bashkëpunimin më të afërt hulumtues dhe mësimdhënës ndërkombëtar.³⁵

Po ashtu, Raporti thekson që ndarja e ECTS-ve në programin doktoral është në përputhje me praktikat ndërkombëtare, gjë që është për t'u përshëndetur.³⁶

Në fund, rekomandimi përfundimtar thotë që Programi Doktoral në Histori, ashtu siç është diskutuar gjatë takimeve dhe hetimit të dokumenteve, ende e arsyeton një vlerësim pozitiv. Rekomandimet e dhëna nga ekipi i ekspertëve të jashtëm duhet të shfrytëzohen për përmirësimin e programit. Programi doktoral në Histori rekomandohet për vazhdim të miratimit për tre vite.³⁷

3.2.2 Akreditimi i Programit Doktoral në Departamentin e Sociologjisë

Programi doktoral në Sociologji, *Transformimet shoqërore, integrimet dhe vlerat*, është akredituar duke u bazuar në Raportin final të 24 qershorit 2014 të grupit të ekspertëve të jashtëm.³⁸

³⁴ Ibid., fq. 26.

³⁵ Ibid. Lidhur me këtë duhet theksuar që me analizimin e kurrikulave të dhëna në ueb-faqen e Departamentit të Historisë, vërehet që Gjuha Angleze nuk figuron si lëndë në asnjërën nga kurrikulat e të tri niveleve studimore në këtë departament. Kjo mungesë e Gjuhës Angleze si lëndë, në të njëjtën kohë kur me Rregulloren e Studimeve të Doktoratës në UP nga studentët doktoralë kërkohet botimi i punimeve në revistat e indeksuara ndërkombëtare, e vështirëson jashtëzakonisht shumë përmbushjen e kriterëve të kërkuara nga studentët, dhe e vë në pikëpyetje përkushtimin e departamentit për studime cilësore, dhe sidomos në nivelin doktoral.

³⁶ Ibid., fq. 32.

³⁷ Ibid., fq. 32-3.

³⁸ *Vizita e AKA në Universitet, 25-26 maj 2014, Procedura e ri-akreditimit të Fakultetit Filozofik*, fq. 8-12, 24 qershor 2014.

Në fillim, në Raport lavdërohet përqendrimi në transformimet shoqërore, dhe, posaçërisht, në dimensionet kulturore të transformimeve, që do të thotë në vlera dhe identitet. Sa i përket kritereve të pranimit, lavdërohet ai i kërkesës për njohuri të çertifikuar të gjuhës së huaj, për shembull TOEFL-i. Megjithatë, lidhur me këtë shprehen rezerva për mundësinë e pranimit në studimet doktorale vetëm me premtimin e nënshtrimit të mëvonshëm në testin TOEFL. Për këtë rekomandohet që të pranohen vetëm studentët me njohuri të çertifikuar të gjuhës së huaj, domethënë me testin e dhënë në TOEFL. Po ashtu, lidhur me grupet e synuara të kandidatëve, në Raport rekomandohet pranimi vetëm i sociologëve me MA. Lëndët e semestrit të parë, të cilat nuk përcaktohen nga Departamenti, por nga Universiteti, në Raport vlerësohen si humbje e kohës së çmueshme të studentëve. Aty theksohet që në mesin e lëndëve të programit studimor vërehet një mungesë e theksuar e metodave hulumtuese sasiore dhe cilësore, dhe që ka mungesë të lëndëve që e shoqërojnë shkrimin e tezës së doktoratës.³⁹

Ndërkohë që në Raport përmendet që personeli i Departamentit është shkolluar jashtë, ai jep vërejtje për përvojën e kufizuar të tij në mësimdhënie në nivel të doktoratës, duke theksuar që ai ka dhënë mësim për më pak se vetëm pesë teza të doktoratës.⁴⁰

Lidhur me hulumtimin, theksohet që mungesa e programeve të mjaftueshme kombëtare të hulumtimit, dhe e fondeve të nivelit universitar, është një nga pengesat kryesore për zhvillimin e një sistemi funksional shkencor në Kosovë. Një universitet pa hulumtim, thuhet, është vetëm një shkollë që pretendon, por që gabimisht e ka fituar një emër tjetër. Raporti vë në dukje që një mënyrë e shmangies së këtij problemi, që e forcon potencialin për hulumtime është programi i doktoratës.⁴¹

Sa i përket financave dhe infrastrukturës në Raport hapësirat në dispozicion vlerësohen si të mjaftueshme, edhe pse ka vërejtje lidhur me mosshfrytëzimin e dhomave të kompjuterëve për mësimin e programeve kompjuterike për hulumtime statistikore, si p.sh. SPSS. Për më keq në Raport bëhen vërejtje serioze për varfërinë e bibliotekave që janë në dispozicion duke theksuar se këto biblioteka kanë fare pak libra. Qasja në kompjuterë dhe në bibliotekat elektronike në

³⁹ Ibid., fq. 8-9.

⁴⁰ Ibid., fq. 10.

⁴¹ Ibid., fq. 11.

fakultet nuk ekziston. Në Raport theksohet që në qendër të shkencës bashkëkohore është leximi i pavarur i komunikatave dhe publikimeve shkencore të shkruara, dhe aty rekomandohet që të bëhet sa më shpejtë themelimi i një biblioteke funksionale.⁴²

Po ashtu, në Raport theksohet mungesa e menaxhimit të cilësisë, duke vërejtur që në Raportin e Vetë-Vlerësimit të Departamentit nuk ka asnjë dokument që i regjistron reagimet e studentëve të doktoratës lidhur me mësimdhënësit. Rekomandohet që Departamenti ta zhvillojë një formë të tillë të kontrollimit të cilësisë.⁴³

Në fund, në Raport ofrohen rekomandimet përfundimtare sipas të cilave, prezantimi i Programit të Doktoratës në Sociologji, infrastruktura e parë gjatë vizitës në institucion, dhe përshtypjet gjatë analizimit të dokumenteve të dorëzuara, e justifikojnë akreditimin e Programit të Doktoratës në Sociologji, por me përmbushjen e disa kushteve. Këto kushte janë: Domosdoshmëria e një plan-projekti dhe e njohurisë së certifikuar të një gjuhe të huaj gjatë pranimit; Prezantimi i një kolloquiumi të obligueshëm, dhe; Obligimi i një kontrate udhëzimi gjatë vitit të parë të studimit, duke përfshirë një mësimdhënës të punësuar nga jashtë Kosovës. Rekomandohet që me përmbushjen e këtyre kushteve, programi të aprovohet për një periudhë tre-vjeçare.⁴⁴

3.3 Aspekte akredituese të studimeve doktorale në UP

Në vijim ofrohet një vlerësim i përgjithshëm i procesit akreditues, ashtu siç ai u shpreh nga respondentët në intervistat e realizuara në kuadër të këtij hulumtimi, si dhe disa nga vërejtjet dhe idetë lidhur me këtë proces që ata i dhanë gjatë këtyre intervistave.

⁴² Ibid., fq. 11-12.

⁴³ Ibid., fq. 12.

⁴⁴ Ibid., fq. 12.

3.3.1 Vlerësimi i përgjithshëm i procesit akreditues të programeve doktorale

Marrë në përgjithësi, procesin akreditues respondentët e vlerësuan mjaft mirë. Megjithatë, në intervistat e zhvilluara u bënë disa vërejtje rreth këtij procesi dhe përmbushjes së synimeve të tij, si dhe u dhanë ide lidhur me punën e mëtutjeshme të AKA-së. Vërejtjet dhe çështjet kryesore të identifikuara janë si në vijim: Kriteret shtesë që duhet të përfshihen në procesin akreditues për ta mundësuar luftimin e efektshëm të plagjiaturës; Ideja që në procesin e akreditimit të inkorporohet edhe vlerësimi i cilësisë së punimeve dhe hulumtimeve doktorale të mëparshme; Nevoja për futjen në programet studimore doktorale të modulit për përgatitjen e shkrimit të doktoratës, dhe; Ideja për akreditimin për mentorim të profesorëve në studimet e doktoratës.

Çështja e shfrytëzimit të procesit akreditues për ta mundësuar një luftim më të efektshëm të plagjiaturës u shtrua nga Hyseni, Departamenti i Sociologjisë. Një ndër problemet e mëdha, sipas tij, është plagjiatura e përhapur gjerësisht, e cila shkon madje edhe përtej niveleve të arsimit të lartë. Prandaj, ai e shtron nevojën që procesi i akreditimit duhet ta përfshijë edhe kërkesën obligative për Fakultetin dhe Universitetin, për ruajtjen afatgjatë të të gjitha materialeve që kandidatët i shfrytëzojnë gjatë punimit të doktoratës, si dhe të punimeve që ata i bëjnë gjatë këtyre studimeve, përfshirë këtu posaçërisht tezën e doktoratës. Kjo, sipas Hysenit, do të mundësojë që nëse ka keqpërdorime dhe plagjiaturë nga ana e kandidatëve, ato do të mund të zbulohen dhe shfrytëzohen nga institucionet ligjore në çfarëdo periudhë të jetës aktive në punë të kandidatit, praktikë e vërejtur nga ai në sistemin arsimor të SHBA-ve.⁴⁵

Problemi i plagjiaturës është një ndër problemet më të rënda të sistemit të arsimit të lartë në Kosovë. Kështu, për shembull, Doktoranti/ja 1 thekson që studentët i dorëzohen plagjiaturës meqë nuk ka mekanizëm që e rrit etikën për mënyrën si duhen shkruar punimet shkencore. Kështu, si pasojë e mungesës së vetëdijes plagjiatura është shndërruar në pjesë përbërëse të tërë sistemit arsimor në Kosovë, dhe posaçërisht të arsimit të lartë.⁴⁶ Prandaj, ideja e dhënë nga

⁴⁵ Intervistë, Agim Hyseni, Prishtinë, 25 dhjetor 2017.

⁴⁶ Intervistë, Doktoranti/ja 1, Prishtinë, 27 dhjetor 2017.

Hyseni për luftimin e plagjiaturës edhe përmes procesit akreditues, është një që do ta afirmonte punimin origjinal, dhe do ta vështirësonte përhapjen e plagjiaturës në sistemin e arsimit të lartë.

Sipas Saqipit, Fakulteti i Edukimit, kriteret akredituese në përgjithësi janë në rregull. Mirëpo, në të ardhmen do të duhej që akreditimi të përqendrohet dhe ta analizojë më shumë cilësinë e produktit final, si projektet hulumtuese dhe disertacionet e studentëve. Saqipi mendon që në kushte të një akreditimi të mirëfilltë programet doktorale që do të mund të akreditohen do të ishin fare të pakta. Kështu, sipas tij perioda deri në riakreditim duhet të jetë periudhë tranzicioni që do të shfrytëzohet për zgjidhje të shpejta të problemeve që shfaqen në ndërkohë. Dhe kjo, sipas tij, bëhet me mbështetjen e profesorëve, gjatë kësaj periudhe tranzicionale, për punime të botuara jashtë, për lirim nga obligimet në BA dhe MA, dhe me masa të tjera të ngjashme. Për më tepër, Saqipi në përgjigjet e veta i përmend edhe rekomandimet që i ka bërë AKA, që në programin studimor doktoral të futet edhe moduli për përgatitjen e shkrimit të doktoratës. Përndryshe, ky rekomandim i AKA-së, pos Fakultetit të Edukimit i është bërë edhe Departamentit të Sociologjisë. Kjo ide, që në kurrikulat e studimeve doktorale të përfshihet edhe lënda për mënyrën e përgatitjes së disertacionit, është një që duhet të bëhet obligative për studimet doktorale në të gjitha fakultetet dhe departamentet e UP-së, meqë do ta përmirësonte në një masë të madhe cilësinë e punimeve doktorale.⁴⁷

3.3.2 Akreditimi i profesorëve për mësimdhënie dhe mentorim në studimet doktorale

Si edhe në punimin e parë diskutues lidhur me studimet doktorale në Fakultetin Ekonomik dhe atë Juridik, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të studimeve doktorale në Fakultetin e Edukimit dhe në atë Filozofik, një nga çështjet më të rëndësishme të identifikuara del të jetë nevoja e akreditimit të profesorëve për mësimdhënie dhe mentorim në studimet doktorale. Ideja e një akreditimi të tillë, në një, apo në ndonjë formë tjetër, ka patur përkrahjen e të gjithë respondentëve në intervistat e zhvilluara. Një numër i vogël i respondentëve kanë shprehur rezerva nëse kjo

⁴⁷ Intervistë, Blerim Saqipi, Prishtinë, 9 janar 2018.

duhet ta ketë pikërisht këtë formë të akreditimit, por edhe ata kanë theksuar që ndonjë trajtë e licencimit të profesorëve për mentorim në studimet e doktoratës është e domosdoshme.

Kështu, për shembull Hajdari, Departamenti i Historisë, thekson që kjo ide është shtruar dhe diskutuar, por që kjo mund të arrihet jo vetëm me akreditimin e profesorëve, por edhe me respektimin e kriterëve për avancimin e tyre. Për më tepër, sipas Hajdarit, nëse shkohet me akreditim të profesorëve, kjo mund të hapë telashe me profesorët që i kanë marrë titujt në mënyrë të ligjshme para më shumë se 20 vitesh, sipas kriterëve të atëhershme.⁴⁸

Nga ana tjetër, Saqipi konsideron që kriteret për mentorim duhet të ngriten, mirëpo është më mirë që kjo të bëhet përmes vendosjes së kriterëve në nivel të Universitetit dhe të fakultetit, jo përmes AKA-së. Është e vështirë, thotë Saqipi, që me një AKA të vendoset për çdonjërin profesor se a i ka patur tri apo pesë punimet e duhura. Përndryshe, Saqipi thekson që kriteri i publikimeve në platformën SCOPUS është kriter me vend, meqë është fjala për revista të mira, duke shtuar që nëse një profesor nuk është në gjendje të botojë në to, ai nuk ka se çfarë u tregon studentëve doktoralë. Mirëpo, përfundon Saqipi, nëse kriteri është i mirë, është penguese burokracia, pra, që kjo të imponohet nga jashtë, domethënë, nga AKA.⁴⁹

Ndërkaq, Hyseni thekson që ajo që mund ta avancojë çështjen e akreditimit, është akreditimi i profesorëve që mund t'i mentorojnë studentët e doktoratës – sipas tij, vetëm thirrja formale e profesorit nuk mund të jetë kriter i mjaftueshëm për mentorim.⁵⁰ Ngjashëm, Hoti, Fakulteti i Edukimit, pohon që, sipas rregullave normative, akreditimi bëhet përmes Statutit që i përcakton kompetencat e profesorëve. Pra, sipas tij, akreditimi i profesorëve nuk kërkohet, mirëpo ky, po të bëhej, me siguri që do t'i kontribuonte cilësisë. Ndërkaq, Asistentja në Departamentin e Sociologjisë, Dr. Linda Gusia thotë që mentorimi i mirëfilltë dhe cilësor varet jashtëzakonisht shumë nga përvoja në hulumtim, kështu që numri i hulumtimeve duhet të jetë përcaktues për përzgjedhjen e mentorëve.

Ngjashëm me shumë respondentë të tjerë edhe Vula, Fakulteti i Edukimit, pohon që titulli nuk bën të jetë i vetmi kriter për lejimin e mentorimit të doktoratave. Për më tepër, shton ajo, ka

⁴⁸ Intervistë, Arben Hajdari, Prishtinë, 26 dhjetor 2017.

⁴⁹ Intervistë, Blerim Saqipi, Prishtinë, 9 janar 2018.

⁵⁰ Intervistë, Agim Hyseni, Prishtinë, 25 dhjetor 2017.

profesorë të asocuar që nuk kanë fare publikime në fushat ku kanë kandidatë që duhet t'i mentorojnë. Kështu që ideja për akreditimin e profesorëve për mentorim sipas saj është për t'u përkrahur. Prandaj, sipas Vulës, akreditimi i profesorëve është hapi i fundit që duhet të bëhet në reformat e studimeve të doktoratës, meqë vetëm thirrjet e profesorëve nuk mjaftojnë.⁵¹

Përkrahës i idesë për akreditimin e profesorëve është edhe Mala, Departamenti i Historisë, vetëm se, ai thotë që kjo duhet të bëhet gradualisht. Në të njëjtën kohë kur kriteret shkojnë duke u bërë më kërkuese, duhet organizuar kurse të veçanta për profesorët, lidhur me metodologjinë e avancuar të hulumtimit, metodologjinë e mentorimit, avancimin e njohurive të tyre në gjuhët e huaja. Për më tepër, vazhdon Mala, akreditimi i profesorëve këtu do të ishte licencim i tyre për mentorim, dhe kjo duhet të bëhet si kusht edhe për avancimin e tyre si profesorë – nëse një profesor pretendon të bëhet i rregullt, ai të mos mund ta realizojë këtë pa e patur këtë lloj licence, domethënë, pa udhëhequr edhe kandidatë doktorale.⁵² Edhe Gjellaj, Fakulteti i Edukimit, thotë që akreditimi i profesorëve për mentorim duhet të ndodhë. Sipas saj, nëse ai nuk bëhet në nivel të AKA-së, ai duhet të bëhet në ndonjë trajtë në nivel të fakulteteve, ashtu që Këshillat e Doktoratës ta bëjnë një licencim të profesorëve për mentorim.⁵³

Ndërkaq, Dekani i Fakultetit Filozofik, Dugolli thotë që profesorët e marrin titullin, por mjaft shpesh nuk vazhdojnë të botojnë dhe hulumtojnë. Kështu, profesorë që punimin e fundit mund ta kenë botuar me dekada më parë, mund të kyqen në mentorim, gjë që është tejet problematike për cilësinë e studimeve doktrale. Prandaj, sipas Dugollit Këshilli Kombëtar i Cilësisë dhe AKA duhet që krahas akreditimit të programeve ta bëjnë edhe akreditimin e profesorëve për mentorim. Profesori nuk mundet *a priori*, vetëm pse e ka thirrjen, të mentorojë, por duhet të shikohet sa është aktiv në kohën e fundit me hulumtime dhe botime.⁵⁴

Përndryshe, këtu duhet theksuar që një nga çështjet kryesore të diskutuara gjatë përgatitjes së programit doktorale në Fakultetin e Edukimit, në bashkëpunim me profesorët e Universitetit të Ljubljanes, ka qenë pikërisht çështja e kriterëve për mentorim. Në këtë rast, profesorët nga Sllovenia kanë ngulmuar që i vetmi kriter të jetë ai i hulumtimeve dhe publikimeve gjatë pesë

⁵¹ Intervistë, Eda Vula, Prishtinë, 29 dhjetor 2017.

⁵² Intervistë, Muhamet Mala, Prishtinë, 9 janar 2018.

⁵³ Intervistë, Majlinda Gjellaj, Prishtinë, 19 janar 2018.

⁵⁴ Intervistë, Bujar Dugolli, Prishtinë, 22 janar 2018.

viteve të fundit. Ky kriter, sipas tyre, duhet të zbatohet pavarësisht nga thirrja e profesorit, madje edhe nëse është fjala për profesorë të rregullt.

4. ASPEKTE TË ADMINISTRIMIT, CILËSISË DHE RESURSEVE HULUMUTESE NË STUDIMET E DOKTORATËS

Në këtë kapitull do të trajohen problemet kryesore të identifikuar gjatë intervistave që i karakterizojnë administrimin, cilësinë dhe hulumtimin në studimet e doktoratës në Fakultetin e Edukimit dhe në Fakultetin Filozofik.

4.1 Administrimi i studimeve doktorale dhe çështja e resurseve për këto studime

Një nga çështjet më të rëndësishme të identifikuar gjatë intervistave lidhur me administrimin e studimeve doktorale është ajo e resurseve fare të pakta që ndahen për këto studime, si dhe e pengesave të ndërlydhura burokratike gjatë shfrytëzimit të tyre. Lidhur me këto pengesa, në disa nga intervistat është përmendur edhe ideja e decentralizimit të një numri të funksioneve për të cilat për momentin kompetencat vendim-marrëse i ka Rektorati i UP-së.

Për pagesat që i bëjnë, studentëve doktorale u ofrohet, pak a shumë, vetëm mbarëvajtja e ligjëratave, ndërkaq, mundësi të tjera, ose ka fare pak, ose nuk ka fare.⁵⁵ Sa i përket atyre pak resurseve që ndahen, për shembull, kandidati doktorale Ismet Potera e thekson që në kuadrin e bashkëpunimit me TEMPUS-in, pagesën për qasjen në bibliotekën elektronike e ka bërë UP-ja, por kjo pagesë është bërë me vonesë, kështu që qasja është mundësuar diku me rreth një vit vonesë.⁵⁶ Këtë qasje e thekson edhe doktorantja Shqipe Gashi, por, sipas fjalëve të saj, kjo është e pamjaftueshme, dhe, nga ana tjetër, edhe procedurat e shfrytëzimit të saj janë mjaft të komplikuar. Gashi po ashtu e thekson edhe atë që në Fakultetin e Edukimit është krijuar edhe një kabinet për doktorantë.⁵⁷

Po ashtu, duke folur për resurset e ndara nga UP-ja për studimet doktorale, Vula, Fakulteti i Edukimit, përmend atë që vizitat e profesorëve nga Sllovenia dhe Shqipëria në vitin e dytë i

⁵⁵ Intervistë, Albert Mecini, Prishtinë, 18 dhjetor 2017.

⁵⁶ Intervistë, Ismet Potera, Prishtinë, 27 nëntor 2017.

⁵⁷ Intervistë, Shqipe Gashi, Prishtinë, 24 nëntor 2017.

paguan UP-ja.⁵⁸ Edhe Dugolli, Fakulteti Filozofik, e përmend që ka patur profesorë vizitorë për lëndët e teknologjisë informative, dhe disa nga ta, madje, kanë qenë edhe nga universitete të tjera. Por, thekson ai, numri i studentëve doktoralë është i vogël, kështu që Rektorati shpesh herë kundërshton që një profesor vizitor të angazhohet për, të themi, tre a katër studentë.⁵⁹

Edhe përkundrajt kësaj, është një vlerësim i përgjithshëm, që resurset e ndara janë fare të vogla dhe të pamjaftueshme kur të krahasohen me nevojat. Rektorati nuk e përballon koston, kështu që fakultetet dhe studentët duhet të gjinden.⁶⁰ Sipas Saqipit, mungesa e resurseve duhet kritikuar më së shumti. Universiteti duhet të fillojë t'i shohë studimet e doktoratës, jo si diçka shtesë, por si pjesë integrale të misionit të vet. Planifikimi duhet të bëhet për program. Financimi këtu bëhet ashtu që çdonjëri fakultet e merr një shumë të buxhetit, dhe, pas kësaj, angazhimi i stafit bëhet në mënyrë qendrore. Në fund, shkohet me një kontratë shtesë, apo me mbinormë. Kjo bën që njerëzit nuk ndejnë që punojnë në këtë program, e që e shkakton një problem të madh. Për momentin, angazhimin në doktoratë profesorët e shohin si diçka shtesë, domethënë, kur të kem kohë e bëj, thotë ai.⁶¹

Po ashtu, është edhe problemi i pengesave burokratike në ndarjen e resurseve edhe ashtu të pakta. Saqipi përmend që profesorët mund të aplikojnë në Këshillin Drejtues të Universitetit për udhëtime në konferenca, por, thotë, kjo është tejet burokratike, meqë është absurde që Këshilli Drejtues i Universitetit të vendosë se cili profesor, i cilit fakultet a departament, duhet të shkojë në cilën konferencë.⁶² Nga ana tjetër, Mala e përmend që Departamenti i Historisë ka Memorandum Bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës, mirëpo ka pengesa burokratike nga centralizimi i administratës. Është çështja e pagesave për profesorët vizitorë, që realizohen në mënyrë tejet burokratike, dhe janë shumë të vështira dhe përcillen me vonesa. Kështu, departamenti e ka të vështirë të bashkëpunojë me fakultetet e universiteteve të tjera, meqë aspekte të veçanta të rëndësishme të këtij bashkëpunimi vendosen nga Rektorati. Për t'i mbuluar shpenzimet e ardhjes së profesorëve vizitorë, vazhdon Mala, programe si ERASMUS-i e

⁵⁸ Intervistë, Eda Vula, Prishtinë, 29 dhjetor 2017.

⁵⁹ Intervistë, Bujar Dugolli, Prishtinë, 22 janar 2018.

⁶⁰ Ibid.

⁶¹ Intervistë, Blerim Saqipi, Prishtinë, 9 janar 2018.

⁶² Ibid.

të ngjashme do të mund të ishin zgjidhje, edhe pse edhe kjo është tejet problematike, thotë ai, meqë ERASMUS-in herë e fiton, e herë jo.⁶³ E ndërlidhur me këtë Gusi, Departamenti i Sociologjisë, vëren që kohëve të fundit Fakulteti i Edukimit ka patur një rritje të konsiderueshme të hulumtimit, por, thotë ajo, ata e kanë patur një grant nga *Transformational Leadership*, dhe kjo ka sjellur rezultate të menjëhershme. Por, njësoj si edhe te ERASMUS-i, grantin nga *Transformational Leadership*, herë e fiton, dhe herë jo.

Pengesat burokratike që shfaqen gjatë administrimit të studimeve doktorale, bëjnë që disa nga respondentët të propozojnë zgjidhje më rrënjësore. Për shembull, Hoti, Fakulteti i Edukimit, përmend vështirësitë në procedurat e pagesave të profesorëve mysafirë, dhe thotë që thjeshtësimi i procedurave është domosdoshmëri për studime më cilësore. Është e domosdoshme, thotë ai, që të ketë fonde të caktuara për studimet e doktoratës dhe për veprimet e ndërlidhura me to, ashtu siç më përpara bëhej me Bashkësinë e Shkencës.⁶⁴ Ndërkaq, Hyseni, Departamenti i Sociologjisë, thotë që duhet të ketë resurse shumë më të mëdha për studimet e doktoratës, dhe që këto duhet të delegohen nga Rektori nëpër fakultete, dhe nga fakultetet nëpër departamente. Pa këtë bartje të resurseve pengesat burokratike do të jenë të mëdha, edhe sa i përket përkrahjes, edhe sa i përket realizimit të përkrahjes së studimeve të doktoratës. Më Projekt-Ligjin për Arsimin e Lartë fondet për studimet doktorale duhet të decentralizohen. Sipas tij, ky decentralizim do ta mundësonte rritjen, edhe të përfshirjes, edhe të participimit aktiv. Pos kësaj, kjo do ta mundësonte edhe një mbikëqyrje më të efektshme, meqë është shumë më lehtë që shpenzimi i mjeteve nga departamenti të mbikëqyret nga fakulteti, dhe fakulteti nga Rektori, se të mbikëqyret shpenzimi i mjeteve nga Rektori.⁶⁵

⁶³ Intervistë, Muhamet Mala, Prishtinë, 9 janar 2018.

⁶⁴ Intervistë, Demë Hoti, Prishtinë, 4 dhjetor 2017.

⁶⁵ Intervistë, Agim Hyseni, Prishtinë, 25 dhjetor 2017.

4.2 Kriteret e pranimit në studimet doktorale

E ndërlidhur ngushtë me administrimin e studimeve doktorale është edhe çështja e kriterëve të pranimit të kandidatëve në këto studime. Lidhur me këto kritere, në vazhdim do të përqendrohemi në disa çështje të identifikuara gjatë intervistave, të tilla si: mundësia e manipulimeve gjatë përzgjedhjes së kandidatëve, rëndësia që në kriteret për pranim duhet ta ketë kompetenca e dëshmuar në hulumtim, rëndësia që gjatë përzgjedhjes së kandidatëve duhet ta kenë rezultatet në studimet paraprake në raport me kriteret e tjera, si dhe kriteri i njohjes së gjuhës angleze.

Sa i përket mundësive të manipulimit dhe të shkeljes së rregullave, kjo u përmend nga dy respondentë. Gusia, Departamenti i Sociologjisë, tregon që edhe pse në përzgjedhjen e kandidatëve nuk ka qenë e kyçur drejtpërdrejtë, ka dëgjuar që ka patur dyshime që një pjesë e provimit në gjuhën angleze është manipuluar.⁶⁶ Ndërkaq, Hyseni e shtron çështjen nëse ka raste kur kandidatët favorizohen në bazë të lidhjeve, bashkëpunimit, afriës, apo nepotizmit. Në qoftë se, thotë ai, në fakultet dyshohet me bazë që kandidatët mund t'i kenë marrë paraprakisht testet që do të bijnë në provimin pranues nga gjuha e huaj, atëherë kjo don të thotë që konkurrenca midis aplikantëve nuk është e barabartë. Kjo kërkon domosdoshmërisht që njohja e gjuhëve të huaja të bëhet vetëm me provimin e TOEFL-it.⁶⁷ Çështja e mundësisë së manipulimeve gjatë provimit pranues është gjithsesi një problem i rëndë i studimeve në përgjithësi, dhe i atyre doktorale në veçanti, dhe, ndërkohë që TOEFL-i i domosdoshëm do ta zgjidhte këtë problem në provimin në gjuhën angleze, për provimet e tjera gjithsesi duhet të krijohen mekanizma më të fuqishëm të mbikëqyrjes dhe të transparencës së tyre.

Po ashtu, në disa nga intervistat është përmendur nevoja që hulumtimit që do të bëhet gjatë studimit doktoral të kandidatit duhet t'i jipet një rëndësi shumë më e madhe gjatë përzgjedhjes së kandidatëve. Kështu, Gusia thotë që profesorët kolegë në Departamentin e Sociologjisë kanë ngulmuar që në vitin 2014 që kandidatët të aplikojnë me një letër motivimi, ku do ta

⁶⁶ Intervistë, Linda Gusia, Prishtinë, 27 dhjetor 2017.

⁶⁷ Intervistë, Agim Hyseni, Prishtinë, 25 dhjetor 2017.

përshkruanin hulumtimin që planifikojnë ta bëjnë si dhe dobinë e tij. Por, vazhdon ajo, kjo është refuzuar me arsyetimin që kjo nuk mund të kuantifikohet. Ndërkaq, provimi pranues, vazhdon ajo, ka qenë një lloj improvizimi në trajtën e provimit për pranim në studimet master. Pra, nuk ka patur përzgjedhje bazuar në atë se çfarë ofrojnë kandidatët në hulumtim, por më tepër lidhur me atë se sa i kanë ata të freskëta ato që i kanë mësuar më heret.⁶⁸ Edhe Hajdari, Departamentit i Historisë, e thekson po të njëjtin problem. Duhet, thotë ai, që studentët t'i propozojnë projektet hulumtuese që në fillim, dhe të përzgjidhen në bazë të tyre. Pra, pikët t'u shkojnë studentëve që kanë projekte hulumtuese të mira, dhe jo të shkohet me teste me pyetje-përgjigje që nganjë herë u përngjasojnë testeve të auto-shkollave. Kjo nuk bën për doktoratë, përfundon ai, duhet të ketë një projekt hulumtues të mirë.⁶⁹ Edhe Saqipi thotë që potenciali hulumtues duhet të jetë kriteri kryesor në përzgjedhjen e kandidatëve. Tendencë në UP është që të shkohet kah kriteret më objektive, nota mesatare e të ngjashme, por nuk vlerësohet shumë projekti që studenti duhet ta propozojë për hulumtimin doctoral. Kjo tregon që nuk ka strategji të hulumtimit, atë se çfarë fushash të hulumtimit duhet t'i trajtojmë. Është strategjia hulumtuese ajo në bazë të të cilës ne duhet t'i vlerësojmë projektet hulumtuese të studentëve, dhe, në mungesë të saj, ato projekte trajtohen vetëm formalisht. Kështu që, shpesh vijmë në situatë që të pranojmë studentë me projekte hulumtuese për të cilat ne nuk kemi mentorë – ndërkaq, kriteret pranuese duhet ta vlerësojnë se a kemi mentorë para se studentët t'i pranojmë, konkludoi Saqipi.⁷⁰

Dhënia e një rëndësie shumë më të madhe hulumtimit doctoral në kriteret për pranim të kandidatëve është një parakusht esencial për mbarëvajtjen dhe rritjen e cilësisë së studimeve doktorale. Gjendjen e ilustron Dugolli, që tregon se nga 100 pikët e mundshme, deri 40 mund të sigurohen nga sukcesi në studimet paraprake, ndërkaq 60 pikët e tjera ndahen në tri pjesë të barabarta, deri nga 20 pikë për çdonjërin: për provimin pranues, gjuhën angleze, dhe për projektin hulumtues.⁷¹ Kështu, sipas kësaj qasjeje, dy kriteret më thelbësore dhe më të domosdoshme për një studim doctoral cilësor, projekti hulumtues dhe njohja e gjuhës angleze,

⁶⁸ Intervistë, Linda Gusia, Prishtinë, 27 dhjetor 2017.

⁶⁹ Intervistë, Arben Hajdari, Prishtinë, 26 dhjetor 2017.

⁷⁰ Intervistë, Blerim Saqipi, Prishtinë, 9 janar 2018.

⁷¹ Intervistë, Bujar Dugolli, Prishtinë, 22 janar 2018. Të njëjtat të dhëna i dha edhe Muhamet Mala në intervistën e 9 janarit 2018.

mund të sjellin vetëm nga 20 pikë. Këtu do ta propozonim për diskutim një kësi strukture të peshës së kriterëve, ku dy kriteret e para janë eliminuese, ndërkaq, dy të tjerat janë përzgjedhëse: 1) Kriteri i Gjuhës Angleze, që dëshmohet përmes dhënies së testit TOEFL, që duhet të jetë kriter eliminues; 2) Kriteri i notës mesatare minimale në studimet Bachelor dhe Master (ashtu siç është, 8.00), që po ashtu duhet të jetë kriter eliminues; 3) Kriteri i hulumtimit, sipas të cilit kandidati vlerësohet përmes projektit hulumtues dhe hulumtimeve paraprake, që është kriter përzgjedhës dhe mund t'i sjellë deri në 50 pikë, dhe; 4) Kriteri i njohurive paraprake, ku do të vlerësohen nota mesatare e kandidatit dhe rezultatet në provimin pranues, që po ashtu është kriter përzgjedhës që mund t'i sjellë deri në 50 pikë. Vetëm njohja e gjuhës angleze si kusht i domosdoshëm për të konkurruar, së bashku me animin shumë më të theksuar gjatë vlerësimit kah hulumtimi, mund t'i krijojnë kushtet e domosdoshme për studime doktorale cilësore.

Në intervistat e zhvilluara që të gjithë respondentët kanë qenë të mendimit që dhënia e testit TOEFL duhet të jetë parakusht për pranim në studimet e doktoratës. Në përgjigjet e dhëna ka patur variacione: për shembull, disa prej respondentëve kanë kërkuar gradualitet në vendosjen e këtij kriteri, dhe disa të tjerë kanë kërkuar që në fillim të pranohen edhe studentët që nuk e kanë kaluar TOEFL-in por që kanë qenë afër kalimit, me kusht që atyre dhënia e këtij testi në ndërkohë t'u parashtrohet si kusht që të mund ta paraqesin kërkesën për mbrojtjen e tezës së doktoratës. Sidoqoftë, krijimi i vetëdijes për domosdoshmërinë e njohjes së gjuhës angleze në një nivel të kënaqshëm mund të interpretohet si diçka tejet premtuese. Prandaj, është e rëndësishme që dhënia e TOEFL-it të bëhet parakusht standard i njohur botërisht për të konkurruar për studime të doktoratës në UP.

4.3 Cilësia e studimeve doktorale

Këtu do të shqyrtohen disa aspekte të studimeve doktorale që kanë të bëjnë me cilësinë e tyre, dhe këto janë të ndërlidhura me numrin e studentëve të regjistruar në të gjitha nivelet e studimit, mungesën e standardeve dhe të vlerësimeve reale për cilësinë e studimeve doktorale,

mungesën e mekanizmave për kontrollimin e cilësisë, si dhe çështjen e mungesës së lëndës së gjuhës angleze në programet e organizuara nga Departamenti i Historisë.

Një nga problemet më të mëdha që e pengojnë rritjen e cilësisë së studimeve doktorale është numri tejet i madh i studentëve që regjistrohen në të gjitha nivelet e studimeve, gjë kjo që personelit akademik i krijon ngarkesa të mëdha që i pamundësojnë një angazhim më të madh në hulumtime dhe në studimet doktorale. Këtë problem e vëren Hyseni, që si një zgjidhje për të e thekson interdisciplinaritetin: Kur numri i profesorëve është i vogël në raport me numrin e studentëve, thotë ai, interdisciplinariteti i studimeve doktorale është një zgjidhje për sfidat me të cilat përballet UP-ja. Mirëpo, fatkeqësisht, nuk ka qasje të avancuara ndaj interdisciplinaritetit, kështu që studimet doktorale mbahen në nivel të fakulteteve, dhe rëndom edhe në atë të departamenteve.⁷² E ndërlidhur me këtë, u përmend që kohëve të fundit është vërejtur një rritje e konsiderueshme e hulumtimeve në Fakultetin e Edukimit. Siç u tha, një nga respondentët këtë e ndërlidhi me grantin që ky Fakultet e kishte nga *Transformational Leadership*, dhe ky grant me mjaft gjasë edhe ka patur një ndikim të madh në këtë rritje.⁷³ Mirëpo, këtu duhet shtuar që sipas Hotit, në nivelin Bachelor të Fakultetit të Edukimit kohëve të fundit ka ndodhë një rënie e madhe e numrit të studentëve të regjistruar, nga 800-900 për vit për program, në gjithsejt 120 për program, kështu që, numri i tërësishëm i studentëve në të tërë Fakultetin e Edukimit tash ka rënë në gjithsej 380 veta.⁷⁴ Është për t'u besuar që kjo rënie e numrit të studentëve, me zvogëlimin rezultues të angazhimit të profesorëve në mësimdhënien në bachelor, ka patur po ashtu ndikim në rritjen e shënuar të hulumtimit në Fakultetin e Edukimit. Prandaj, një mënyrë e mirë për arritjen e cilësisë më të lartë në të gjitha nivelet e studimit, dhe posaçërisht në atë doktoral, është kalimi nga sasia në cilësi.

Njërin ndër problemet e mëdha Saqipi e sheh në mungesën e standardeve dhe të vlerësimeve për cilësinë e studimeve doktorale. Sfida kryesore e UP-së sa i përket cilësisë së studimeve doktorale, sipas tij, është në përcaktimin e standardit adekuat, ashtu që studentët të jenë në gjendje të bëjnë punë të mirëfilltë shkencore, ashtu që të mos vazhdohet trendi i hulumtimeve

⁷² Intervistë, Agim Hyseni, Prishtinë, 25 dhjetor 2017.

⁷³ Intervistë, Linda Gusia, Prishtinë, 27 dhjetor 2017.

⁷⁴ Intervistë, Demë Hoti, Prishtinë, 4 dhjetor 2017.

sipërfaqësore pa ndonjë impakt në nivel të shoqërisë, apo edhe në nivelin praktik të profesionit për të cilin përgatiten. Unë, thotë Saqipi, nuk kam ndonjë informacion që është bërë ndonjë vlerësim i brendshëm në Universitetin e kualitetit të hulumtimeve në nivel të disertacioneve. Pra, në UP nuk ka ndonjë debat të brendshëm për të parë se a është punë e mirëfilltë shkencore ajo që bëhet në nivel të disertacionit. Saqipi përqendrohet po ashtu edhe në mekanizmat për sigurimin e cilësisë, të cilët, siç thotë, Universiteti i ka në letër, po nuk i ka të funksionalizuara sa duhet. Standardet për studime cilësore të doktoratës, vlerësimi i përmbushjes së këtyre standardeve, domethënë, vlerësimi i cilësisë së doktoratave të prodhuara, si dhe mekanizmat funksionalë për kontrollimin e cilësisë, në UP në masën më të madhe nuk ekzistojnë.⁷⁵ Edhe pse është një ndër sfidat më të mëdha për UP-në, krijimi i tyre është një domosdoshmëri për të patur studime doktorale cilësore.

Lidhur me mentorimin do të përqendrohemi në çështjen e bashkëmentorimit. Sipas fjalëve të Hotit, në programin doktorale me TEMPUS-in, në Fakultetin e Edukimit, bashkëmentorimi është i obligueshëm, ku njëri mentor është nga Sllovenia, dhe tjetri nga Kosova. Ky bashkëmentorim e rrit cilësinë e doktoratës.⁷⁶ Këtë e ilustron shumë mirë edhe doktoranti Ismet Potera, i cili thotë që, meqë programi është ndëruniversitar, vërehet një konkurrencë e shtuar ndërmjet profesorëve të universiteteve të ndryshme. Kjo, sipas Poterës, vërehet posaçërisht në performancën e profesorëve të UP-së, të cilët punojnë shumë më tepër sesa sikur programi të ishte vetëm i UP-së. Sipas vlerësimit të Poterës, profesorët e Ljubljanes janë shumë më konkret dhe praktikë, ata të Tiranës përpiqen që teorinë që i ligjërojnë t'i ndërlihdin me temat e doktoratës së studentëve të veçantë, dhe profesorët e Prishtinës janë shumë më teorikë.⁷⁷ Në këtë mënyrë, bashkëmentorimi me profesorë nga Kosova dhe Sllovenia e bën një ndërlihdje shumë të mirë të teorisë me praktikën, dhe në këtë mënyrë e rrit në një masë të madhe cilësinë e studimit. Fatkeqësisht, në programet e tjera doktorale dhe të masterit në UP, bashkëmentorimi është fare i rrallë, edhe pse Statuti i UP-së këtë e mundëson. Bashkëmentorimi në UP është i shpeshtë vetëm në programet doktorale që organizohen në

⁷⁵ Intervistë, Blerim Saqipi, Prishtinë, 9 janar 2017.

⁷⁶ Intervistë, Demë Hoti, Prishtinë, 4 dhjetor 2017.

⁷⁷ Intervistë, Ismet Potera, Prishtinë, 27 nëntor 2017.

bashkëpunim me universitetet e jashtme.⁷⁸ Me qëllim të rritjes së cilësisë së studimeve doktorale, UP-ja duhet të ndërmerr masa me qëllim të shpeshimit të praktikës së bashkëmentorimit, ku angazhimi i profesorëve mysafirë për këtë qëllim është vetëm një nga mundësitë e shumta në këtë drejtim.

Në fund, në kapitullin për akreditimin u përmend që, sipas të dhënave në ueb-faqen e Departamentit të Historisë⁷⁹ në asnjërin nga nivelet studimore të këtij Departamenti nuk figuron lënda e Gjuhës Angleze. Të gjitha departamentet e tjera të të dy fakulteteve të shqyrtuara, në të gjitha nivelet e studimeve që i organizojnë, e kanë të paktën një lëndë të Gjuhës Angleze, dhe mjaft shpesh edhe nga dy. Në një situatë ku Departamenti i Historisë organizon studime doktorale, ndërkaq, një ndër kërkesat kryesore për studimet doktorale është kërkesa për botime të jashtme, mungesa e lëndës së Gjuhës Angleze në studimet e organizuara nga ky departament është një mangësi që e kërcënon seriozisht cilësinë e studimeve të tij doktorale – dhe të studimeve të tij në përgjithësi – dhe kjo mangësi duhet të eliminohet në mënyrën më urgjente.

4.4 Hulumtimi dhe aspektet e studimeve doktorale të ndërlidhura me të

Hulumtimi, sipas Hysenit, është pika më e dobët dhe më kritike e arsimit të lartë përgjithësisht. Mungon motivimi i mjaftueshëm për hulumtime empirike në veçanti, si dhe për hulumtimin përgjithësisht. Shumë fusha të jetës tonë shoqërore hulumtohen më tepër nga studiuesit e huaj se nga ata vendorë. Për këtë arsye, sipas Hysenit, duhet një riorganizim i kësaj fushe, prej

⁷⁸ Intervistë, Demë Hoti, Prishtinë, 4 dhjetor 2017.

⁷⁹ <http://filozofiku.uni-pr.edu/Departamentet/Departamenti02.aspx>, dhe, <http://filozofiku.uni-pr.edu/getattachment/Departamentet/Departamenti02/Pasqyre-e-programit-PhD-HISTORI.pdf.aspx>. Këtu duhet theksuar që, në pasqyrën e lëndëve të programit të studimit Master në Arkivistikë, në adresën: <http://filozofiku.uni-pr.edu/getattachment/Departamentet/Departamenti02/Arkivistike-MA.pdf.aspx> të Departamentit të Historisë, lënda Gjuhë Angleze (frenge, gjermane, italiane) ekziston, mirëpo në Orarin e Ligjeratave për po këtë Program MA në Arkivistikë, i cili është i dhënë në adresën: <http://filozofiku.uni-pr.edu/Departamentet/Departamenti02.aspx>, kjo lëndë nuk figuron. Konsiderojmë që duhet theksuar edhe ajo që Pasqyra e Lëndëve të Programit Master në Kohën e Re (shek. 19-20) ([http://filozofiku.uni-pr.edu/getattachment/Departamentet/Departamenti02/Programi-KOHA-E-RE-shek--XIX-XX-\(MA\)-\(1\).pdf.aspx](http://filozofiku.uni-pr.edu/getattachment/Departamentet/Departamenti02/Programi-KOHA-E-RE-shek--XIX-XX-(MA)-(1).pdf.aspx)), në të njëjtën kohë kur nuk e ka lëndën Gjuhë Angleze, e ka atë të Gjuhës Osmane.

formave të motivimit, e deri te përqindja e mjeteve të ndara në nivel të MASHT-it për UP-në dhe për hulumtime.⁸⁰ Këtë Saqipi e përmbledh shkurt: Shteti nuk e sheh shkencën si diçka të rëndësishme, për vetë faktin që nuk e financon. Sipas tij, puna shkencore e hulumtuese është pjesa më e pazhvilluar e punës së UP-së. Nuk ka axhendë hulumtimi, nuk ka program hulumtimi, i cili, pos verbalisht, nuk është pjesë e misionit të UP-së. Hulumtimi është për kohë të lirë, nëse ke të tillë. Zhvillimi i hulumtimit kërkon përkushtim institucional, kohë, resurse, llogaridhënie, dhe, mbi të gjithat, kërkon që të gjitha këto të kordinohen dhe zhvillohen bashkarisht.⁸¹

Saqipi e vë në dukje njërin nga problemet kryesore të ndërlidhura me hulumtimin: Universiteti, sipas tij, nuk ka axhendë të hulumtimit, nuk ka strategji të hulumtimit, dhe këto duhet t'i kenë, jo vetëm universiteti, por çdonjëri fakultet dhe çdonjëri departament. Me fjalë të tjera, nuk janë të përcaktuara fushat e hulumtimit që do të trajtohen, dhe që në bazë të kësaj të vlerësohen projektet doktorale që vijnë prej studentëve. Kësisoj, projektet vlerësohen në një mënyrë tejet formale, dhe vetëm pasi ato të pranohen, shikohet se a ka mentorë për t'i mentoruar ato.⁸² Përndryshe, këtë çështje e përmend edhe Gusia, që përqendrohet në përvojën e Departamentit të Psikologjisë në studimet Master. Masteri në Psikologji, thotë ajo, është shumë i fokusuar, sepse ka më pak studentë, dhe punimet e magjistraturës janë të ndërlidhura me një projekt që vjen nga departamenti. Departamenti merr vendim, në këtë semestër do të trajtohen këto tema të caktuara, dhe më pastaj studentët bashkangjiten me hulumtimet e tyre të magjistraturës.⁸³ Është e qartë që, si edhe te çdo veprimtari tjetër, ashtu edhe te hulumtimi, planifikimi është i domosdoshëm që ky të ketë sukses. Prandaj, përcaktimi i strategjive dhe axhendave hulumtuese, domethënë, përcaktimi i prioriteteve në hulumtim, është parakusht për hulumtim të suksesshëm, kështu që përgatitja e këtyre strategjive dhe axhendave duhet të jetë synim urgjent për të gjitha fakultetet dhe departamentet, dhe posaçërisht për ato që organizojnë studime të doktoratës.

⁸⁰ Intervistë, Agim Hyseni, Prishtinë, 25 dhjetor 2017.

⁸¹ Intervistë, Blerim Saqipi, Prishtinë, 9 janar 2018.

⁸² Ibid.

⁸³ Intervistë, Linda Gusia, Prishtinë, 27 dhjetor 2017.

Në Punimin e Parë Diskutues, nëntor 2017, e përmendëm të ashtuquajturin *Dokumentin e Bardhë*, që i jep standardet dhe normat evropiane sa i përket ngarkesës së punës të profesorëve të rregullt dhe të asocuar. Kemi thënë që për kategorinë e profesorëve të rregullt raporti ndërmjet mësimdhënies dhe hulumtimit duhet të anojë kah hulumtimi intenziv, dhe atë me 10% mësimdhënie, 70% hulumtim, ndërkaq 20% shkon në shërbimet e tjera. Ndërkaq, për kategorinë e profesorëve të asocuar, ky raport rekomandohet të jetë me 20% mësimdhënie, 60% hulumtim dhe 20% shërbime të tjera.⁸⁴ Ndërkaq, profesorët e UP-së as për së afërmi nuk mund t'i arrijnë këto raporte evropiane midis mësimdhënies dhe hulumtimit. Sipas Hotit, profesori i ka 6 orë në javë, dhe asistenti 10, që lë fare pak mundësi për lehtësimin e hulumtimit.⁸⁵ Për më tepër, Gusia thekson që kjo ngarkesë është edhe më e madhe, duke thënë që ajo vetë është e ngarkuar me 17 orë në javë. Çështja qëndron në numrin tejet të madh të studentëve të cilëve duhet t'u mbahen ligjëratat. Sipas saj, nëse një profesor tërhiqet nga ligjëratat, ekziston rreziku që të kollopsojë i tërë sistemi i mësimdhënies, meqë nuk ka mjaft profesorë për t'i zëvendësuar për ligjëratat e tyre.⁸⁶ Çështja e shkarkimit të profesorëve nga obligimet mësimdhënëse ashtu që ata të mund të merren më tepër me hulumtim, është gjithsesi një nga problemet më të vështira, por edhe më të domosdoshme me të cilat duhet të përballet UP-ja.

Sa i përket kërkesës për botime të jashtme të studentëve doktoralë, ashtu siç kjo është e parashtruar nga UP-ja, pra, nëpër revista të jashtme të indeksuara, respondentët kanë patur mendime të ndryshme, dhe nganjëherë edhe të kundërta. Përndryshe, edhe këtu e kemi vërejtur një trend që është parë gjatë përgatitjes së Punimit Diskutues të Parë, për studimet doktorale në Fakultetin Ekonomik dhe në atë Juridik. Aty Programi Doktorat i Fakultetit Ekonomik ka qenë i organizuar së bashku me TEMPUS-in, ndërkaq, Fakulteti Juridik, nuk ka patur të tillë. Kemi vërejtur që përkrahja për punimet e jashtme ka qenë shumë më e lartë në Fakultetin Ekonomik, pra aty ku kishte bashkëpunim me TEMPUS-in. Edhe në rastin e tashëm,

⁸⁴ *Dokumenti i bardhë: Modeli financiar për Sistemin e Arsimit të Lartë Publik në Kosovë* (FAITH: Rritja e autonomisë financiare dhe llogaridhënies së institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë), 544142-TEMPUS-1-2013-1-AT-TEMPUS-SMGR. Cituar nga, *Studimet Doktorale në Fakultetin Ekonomik dhe atë Juridik të Universitetit të Prishtinës*, Punim për diskutim, KIPRED, CPC; Nëntor 2017.

⁸⁵ Intervistë, Demë Hoti, Prishtinë, 4 dhjetor 2017.

⁸⁶ Intervistë, Linda Gusia, Prishtinë, 27 dhjetor 2017.

Fakulteti i Edukimit ka program doktoral me TEMPUS-in, ndërkaq Fakulteti Filozofik jo. Përsëri, përkrahja e kriterit të publikimeve të jashtme ka qenë shumë më e theksuar te respondentët nga Fakulteti i Edukimit, që ka bashkëpunim me TEMPUS-in, se te ata të Fakultetit Filozofik, që nuk e ka një bashkëpunim të tillë. Arsyeja duket se qëndron në faktin që bashkëpunimi me TEMPUS-in, dhe, rrjedhimisht, edhe mentorimi i profesorëve nga universitetet evropiane (në këtë rast, i profesorëve sllovenë), studentëve u ndihmon në rritjen e shkathtësive për përgatitjen e punimeve për botim të jashtëm, kështu që këta studentë nuk e kanë ndonjë prirje të theksuar që kërkesën për një botim të tillë ta shohin si diçka tejet problematike.

Rezervat dhe vërejtjet ndaj kriterit të botimeve të jashtme, ashtu siç ky është përcaktuar në Rregulloren për Studime Doktorale të UP-së, janë shprehur posaçërisht nga respondentët nga Departamenti i Historisë. Gjatë intervistave me ta është përmendur, për shembull, fakti që një numër i kandidatëve doktoralë të mëparshëm kanë ngecur në proces, meqë Këshilli Qendror i Doktoratës punimet e botuara nuk ua ka njohur si botime ndërkombëtare.⁸⁷ Po ashtu, është argumentuar që është vështirë të bëhen botime të jashtme në fushat që kanë të bëjnë me kulturën shqiptare, si, për shembull, Gjuha, Historia apo Etnologjia.⁸⁸ Mes tjerash, është theksuar edhe ajo që revistat për këto fusha që botohen në Prishtinë dhe në Tiranë, dhe që janë revistat kah të cilat studiuesit e këtyre fushave janë të orientuara më së shumti, nuk njihen si kontribut hulumtues nga UP-ja.⁸⁹

Kërkesa për të paktën një publikim gjatë studimeve të doktoratës sipas Vulës nuk është vetëm e UP-së, por ekziston në të gjitha universitetet serioze në rajon e më gjërë.⁹⁰ Po ashtu, Gjellaj mendon që kërkesa për një botim në revistat ndërkombëtare me impakt-faktor nuk është e rëndë. Kjo, nga ana tjetër, e përgatit studentin për punim cilësor të tezës së doktoratës. Qëllimi, thotë Gjellaj, nuk është ta rrisim numrin e personave të doktoruar – sado e mirëseardhur dhe e nevojshme që të jetë kjo – por që ata që i doktorojmë t'i plotësojnë disa kriterë elementare të

⁸⁷ Intervistë, Arben Hajdari, Prishtinë, 26 dhjetor 2017. Po ashtu, Intervistë, Muhamet Mala, 9 janar 2018.

⁸⁸ Intervistë, Muhamet Mala, Prishtinë, 9 janar 2018.

⁸⁹ Intervistë, Bujar Dugolli, Prishtinë, 22 janar 2018. Po ashtu, Intervistë, Muhamet Mala, Prishtinë, 9 janar 2018.

⁹⁰ Intervistë, Eda Vula, Prishtinë, 29 dhjetor 2017.

domosdoshme për të qenë shkencëtarë. Nevojat për staf në UP janë shumë të mëdha, por këto janë nevoja për staf cilësor, thotë ajo, dhe jo thjeshtë për staf numër.⁹¹

Në thelb të vetin, problemet që kanë të bëjnë me botimet e jashtme janë probleme të shkaktuara nga mentorimi joadekuat. Studentët doktoralë që kanë bashkëmentorë sllovenë, çështjen e botimit jashtë nuk e shohin si aq problematike, meqë mentorimi i profesorëve sllovenë, apo, përgjithësisht, i atyre evropianë, është cilësor, dhe për këtë arsye ky atyre u mundëson që këtë kriter ta plotësojnë me lehtësi. Këtë e vëren shumë mirë Saqipi, që thotë që kërkesa për botimet e jashtme duhet të mbetet, por kësaj duhet t'i bashkangjitet edhe kërkesa që nëse profesori mentor nuk ka botuar asgjë jashtë, ai duhet të hiqet nga mentorimi, dhe të zëvendësohet me një tjetër që e plotëson këtë kërkesë. Profesori që ka botuar jashtë të ndihmon, thekson Saqipi, ai që më parë e di se të çfarë natyre mund të jenë komentet që punimi i studentit mund t'i ketë në procesin e recensionit ndërkombëtar, domethënë në *peer-review*⁹² Ndërkaq, sa i përket revistave vendëse, këto, sipas Saqipit do të ishin të mirëseardhura, por është vështirë të krijohen me standarde ndërkombëtare. Sipas tij, më së miri është të vazhdohet me kriterin e botimit në platformën SCOPUS për profesorët, dhe, më pastaj, me rritjen e numrit të profesorëve që botojnë jashtë, krijohen kushte më të mira për fillimin e botimit të revistave tona që do të jenë mirëfilli cilësore. Ajo që UP nuk ka revista të mira, përfundon Saqipi, nuk është problem shqetësues, për aq kohë sa UP-ja punon për krijimin e rrethanave ku revistat e mira do të mund të krijoheshin. Nismat për botimin e revistave shkencore në Kosovë duhet të përkrahen nga UP-ja, mirëpo, duhet t'i ikim logjikës, unë ta botoj një punim ty, dhe ti ma boton një mua.⁹³

Kjo mënyrë arsyetimi me mjaft besueshmëri do të mund të zbatohet edhe për një problem tjetër të ndërlidhur me hulumtimin shkencor në UP, atë të instituteve jofunksionale shkencore të fakulteteve të UP-së dhe të departamenteve të tyre. Mungesa e punës së këtyre instituteve është vërejtur dhe theksuar nga pjesa më e madhe e respondentëve në intervistat e zhvilluara,

⁹¹ Intervistë, Majlinda Gjelaj, Prishtinë, 19 janar 2018.

⁹² Intervistë, Blerim Saqipi, Prishtinë, 9 janar 2018.

⁹³ Ibid.

si njëri ndër problemet e mëdha të ndërlidhura me hulumtimin në UP.⁹⁴ Mirëpo, në kohën kur UP-ja është duke i bërë hapat e parë në themelimin e një hulumtimi më serioz që do t'i plotësonte kriteret elementare shkencore perëndimore, prioritet duhet të jetë krijimi i një kategorie hulumtuesisht kosovarë që i plotësojnë këto kritere, ndërkaq, funksionalizimi i instituteve mund, dhe do të duhej, të bëhet pas krijimit dhe forcimit fillestar të kësaj kategorie hulumtuesish.

Mirëpo, kjo kursesi nuk i arsyeton disa probleme të tjera të ndërlidhura me hulumtimin, si atë të qasjes inekzistente apo tejet të kufizuar në bibliotekat elektronike, atë të gjendjes mjaft të varfër të bibliotekave fizike, si dhe literaturën mjaft të pakët që shfrytëzohet në studimet doktorale, dhe mënyrën mjaft problematike të shfrytëzimit të saj. Sipas respondentëve, mjetet që UP-ja i ndan për bibliotekat fizike janë fare të pakta, kështu që furnizimi me libra dhe me literaturë në masë të madhe varet nga donacionet.⁹⁵ Për më tepër, mësimdhënësit e UP-së pothuaj që nuk bëjnë fare mbikëqyrje në baza javore të përcjelljes së literaturës nga ana e studentëve të tyre, edhe pse kjo është një praktikë e rregullt e profesorëve sllovenë në ligjeratat e tyre në Fakultetin e Edukimit.⁹⁶ Ndërkaq, gjendja tejet e rëndë sa i përket qasjes së studentëve doktorale në bibliotekat elektronike, dhe problemet me të cilat këta studentë përballen për shkak të kësaj, janë theksuar nga pothuaj të gjithë respondentët.⁹⁷ Këtu mund vetëm të konkludojme që dështimi i UP-së që studentëve doktorale t'u ofrojë qasje në revistat ku UP-ja kërkon që ata studentë të botojnë, këta studentë i vë në një situatë paradoksale ku nga ata kërkohet të marrin pjesë në proceset shkencore të cilat ata nuk kanë mundësi t'i përcjellin.

⁹⁴ Intervistat: Agim Hyseni, Prishtinë, 25 dhjetor 2017; Arben Hajdari, Prishtinë, 26 dhjetor 2017; Eda Vula, Prishtinë, 29 dhjetor 2017; Blerim Saqipi, Prishtinë, 9 janar 2018; Muhamet Mala, Prishtinë, 9 janar 2018; Majlinda Gjelaj, Prishtinë, 19 janar 2018; Bujar Dugolli, Prishtinë, 22 janar 2018.

⁹⁵ Intervistë, Demë Hoti, Prishtinë, 4 dhjetor 2017.

⁹⁶ Intervistë, Majlinda Gjelaj, Prishtinë, 19 janar 2018.

⁹⁷ Intervistat me profesorët: Demë Hoti, Prishtinë, 4 dhjetor 2017; Albert Mecini, Prishtinë, 18 dhjetor 2017; Agim Hyseni, Prishtinë, 25 dhjetor 2017; Arben Hajdari, Prishtinë, 26 dhjetor 2017; Linda Gusia, Prishtinë, 27 dhjetor 2017; Eda Vula, Prishtinë, 29 dhjetor 2017; Blerim Saqipi, Prishtinë, 9 janar 2018; Majlinda Gjelaj, Prishtinë, 19 janar 2018; Bujar Dugolli, Prishtinë, 22 janar 2018. Po ashtu, intervistat me studentët doktorale: Shqipe Gashi, Prishtinë, 24 nëntor 2017; Ismet Potera, Prishtinë, 27 nëntor 2017; Albert Mecini, Prishtinë, 18 dhjetor 2017; Doktoranti/ja 1, Prishtinë, 27 dhjetor 2017.

5. KONKLUZIONE PËR DISKUTIM

A) Agjencioni i Kosovës për Akreditim deri më tash ka shërbyer më tepër si një mekanizëm për verifikim formal të plotësimit të kushteve për studimet doktorale, pa u përqendruar në dimensionet përmbajtësore:

Çështjet për diskutim:

- Në procesin e ri-akreditimit të studimeve doktorale të inkorporohet edhe vlerësimi i cilësisë së punimeve dhe hulumtimeve të mëparshme doktorale;
- Me qëllim të luftimit të plagjiaturës procesi i akreditimit duhet ta përfshijë edhe kërkesën obligative për Fakultetin dhe Universitetin, për ruajtjen afatgjatë të të gjitha materialeve që kandidatët i shfrytëzojnë gjatë punimit të doktoratës, si dhe të punimeve që ata i bëjnë gjatë këtyre studimeve, përfshirë këtu posaçërisht tezën e doktoratës;
- Futja në programet studimore doktorale të modulit për përgatitjen e shkrimit të doktoratës, meqë ky do të ndikojë në një mënyrë përmbajtësore në përmirësimin e cilësisë së punimeve doktorale;
- Akreditimi i profesorëve për mentorim në studimet e doktoratës - thirrja formale universitare rezulton të jetë kriter i domosdoshëm, por jo edhe i mjaftueshëm. Përvoja në hulumtim dhe numri i hulumtimeve të botuara në revista kredibile shkencore gjatë pesë viteve të fundit duhet të jenë përcaktuesit kryesorë për akreditimin e profesorëve për mentorimin e temave të doktoratës.

B) Resurset fare të pakta që ndahen për studimet doktorale, si dhe pengesat e ndërlidhura burokratike gjatë shfrytëzimit të tyre e ulin cilësinë dhe e pengojnë progresin e këtyre studimeve. Studentëve doktorale u ofrohet vetëm mbarëvajtja e ligjëratave, ndërkohë që mundësitë e tjera janë fare të kufizuara. Për këtë arsye, Universiteti duhet të fillojë që studimet e doktoratës t'i shikojë, jo si diçka shtesë, por si pjesë integrale të misionit dhe të studimeve të veta.

Çështjet për diskutim:

- Pagesat për qasje në biblioteka elektronike nga UP-ja duhet të bëhen pa vonesa në mënyrë që profesorët dhe studentët ato t'i kenë në dispozicion pa ndërprerje;
- Duhet të bëhet decentralizimi i vendimmarrjes, nga Rektorati në fakultete, dhe nga fakultetet në departamente;
- Rritja e buxhetit dhe decentralizimi në fakultete i vendim-marrjes për pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe për profesorët vizitorë, duke patur parasysh edhe faktin që grantet p.sh. ERASMUS, Transformational Leadership, etj. edhe përkundrejt kontributit të tyre të madh, nuk janë, as të mjaftueshme, dhe as të sigurta.

C) Kriteret e tashme për pranim në studimet e doktorale janë joadekuate dhe japin hapësirë për vlerësim jo-objektiv të aplikuesve, gjë që e ul cilësinë e këtyre studimeve.

Çështjet për diskutim:

- Njohja e gjuhës angleze duhet të jetë kriter eliminues dhe jo vlerësues për pranim në studimet doktorale. Njohja e gjuhës angleze duhet të dokumentohet me rezultatet e testit të TOEFL-it, ndërkaq për organizimin e tij mund të gjendet përkrahje edhe nga prezenca ndërkombëtare në Kosovë;
- Nota mesatare mbi tetë në studimet baçelor **dhe** master duhet të jetë kriter eliminues për pranim në studimet doktorale;
- Vlerësimi i diturisë paraprake dhe i aftësive hulumtuese, përfshirë këtu edhe projektin hulumtues, duhet të bëhen në mënyrë të barabartë, për të pasur një kriter të besueshëm që mundëson cilësi në studimet dhe në përgatitjen e hulumtimit doctoral.

D) Sfida kryesore e UP-së sa i përket cilësisë së studimeve doktorale është në përcaktimin e standardeve adekuate, ashtu që studentët të jenë në gjendje të realizojnë hulumtime të mirëfillta shkencore. Kjo në një masë të madhe do ta ndërprente trendin e hulumtimeve

sipërfaqësore pa ndonjë rezultat të mirëfilltë shkencor, apo edhe në nivelin praktik të profesionit për të cilin studentët doktoralë përgatiten.

Çështjet për diskutim:

- UP-ja duhet të ndërtojë mekanizma të brendshëm të kontrollit të cilësisë që do të bënin vlerësim vjetor të kualitetit të hulumtimeve në nivel të disertacioneve, për të nxjerrë vlerësime se a është punë e mirëfilltë shkencore ajo që bëhet në nivel të disertacioneve të doktoratës;
- Aplikimi obligativ dhe financimi i bashkë-mentorimit me profesorë nga universitetet e jashtme;
- Futja e gjuhës angleze në programet e studimeve baçelor dhe master të Departamentit të Historisë.

E) Hulumtimi është pika më e dobët dhe më kritike e arsimit të lartë. Shteti nuk e sheh shkencën si diçka të rëndësishme, për vetë faktin që nuk e financon. Puna shkencore e hulumtuese është pjesa më e pazhvilluar e punës së UP-së.

Çështjet për diskutim:

- Si UP-ja, ashtu edhe fakultetet dhe departamentet e tij duhet t'i formulojnë dhe zbatojnë strategjitë dhe axhendat përkatëse të hulumtimit, dhe për këtë UP-ja, përkatësisht MASHT-i, duhet të sigurojë financimin e duhur. Kjo duhet të shoqërohet edhe me funksionalizimin e instituteve ekzistuese dhe themelimin e të reja;
- Përcaktimi i strategjive dhe fushave të hulumtimit nga fakultetet, përkatësisht departamentet, do ta mundësonte vlerësimin e duhur të projekteve doktorale që vijnë prej studentëve, dhe me këtë do të shmangeshin, si vlerësimi formal i projekteve të tyre doktorale, ashtu edhe problemet e deritashme lidhur me mungesën e mentorëve;
- Profesorët dhe mentorët e studimeve doktorale duhet të shkarkohen gradualisht nga obligimet mësimdhënëse, me qëllim që të mund të merren më tepër me hulumtim, ashtu siç edhe rekomandohet në Dokumentin e bardhë: Modeli financiar për Sistemin e Arsimit të Lartë Publik në Kosovë;

- Kriteri për botimet e jashtme për studentët doktoral është i domosdoshëm, por këtij kriteri duhet t'i bashkangjitet edhe kërkesa që nëse profesori mentor nuk ka botuar të paktën tre punime në pesë vitet të fundit, ai duhet të hiqet nga mentorimi, dhe të zëvendësohet me një tjetër që e plotëson këtë kërkesë;
- Botimi i revistave shkencore duhet të përkrahet nga UP-ja, mirëpo ky duhet të jetë proces gradual që do të siguronte cilësinë e tyre, fillimisht duke e ngritur substancialisht numrin e publikimeve të profesorëve në revista kredibile, dhe më pas me sigurimin e bordeve editoriale ndërkombëtare dhe shqyrtimet profesionale anonime. Në këtë mënyrë, në një kornizë kohore afatmesme do të mund të sigurohej edhe listimi i revistave të UP-së në platforma kredibile dhe cilësore.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

Ky botim është përkrahur nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP), financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K), dhe nga Bashkëpunimi për Zhvillim Ndërkombëtar i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Danimarkës (DANIDA), dhe është menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).